



Opština Klokot \ Komuna e Kllokot

Në bazë të nenit 43.Të Ligjit për vetqeverisje lokale 03/L-040,si dhe Statutit të komunës sipas nenit 18 me datën 25.11.2020 është mbajtur seanca e njëmbëdhjetë e rregullt e Kuvendit komunal të Kllokotit,me rendin e ditës të përgaditur më parë. Me atë rast është hartuar si në vijim:

PROCESVERBALI NGA SEANCA E NJËMBËDHJETË E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL KLLOKOT

Kryesuesi i Kuvendit komunal Zarko Dejanovic e hapi seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit komunal të Kllokotit në orën 11:00,përmes linjes telefonike online me aplikacionin viber,i përshëndeti të gjithë të pranishmit. Të pranishëm në seancë ishin Dragisa Kojic,Vlasta Bogdanovic asistent,nëkruetari i komunës Sasa Mirkovic si dhe përkthyesja e komunës znj.Diturie Ramiqi,thirrjet telefonike për secilin delegat individualisht u bënë nga zyra e nënkryetarit të komunës. Seancës i'u përgjigjën të gjithë 15 delegatët e kuvendit.

Rendi i ditës

1. Propozim vendimi mbi shqyrtimin dhe miratimin e vendimit të kuvendit komunal për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave për personat juridik;
2. Të ndryshme;

Kryesuesi filloi me thirrjen e delegatëve,po ashtu kryesuesi njofton që zëvendëskryesuesi z.Hidajet Ahmeti është drejtuar në formë të shkruar për këtë seancë pasi që gjindet në mësim dhe nuk mund të marrë pjesë në seancë.

Hidajet Ahmeti : Përshëndetje për Kryesuesin ,delegatët e Kuvendit komunal dhe të gjithë zyrtarët tjerë të cilat kontribuojnë në këtë proces.

1. Për pikën e parë jam **KUNDRA**. Mendoj se komuna si institucion e shërbim për qytetarët në këtë kohë pandemia kish qenë e rrugës që bizneset t'i liroj nga disa taksa komunale përkohësisht deri në kthimin në normalitet. Në këtë rast, shërbimin për mbeturina është mirë që ta kry falas për gjitha kategoritë biznesore, por pse jo edhe për ekonomitë familjare. Jam I vetëdijshëm se është një barrë e rëndë për komunën, por duhet te kemi parasysh se është fjala për një gjendje të jashtëzakonshme ku ndihma e institucionit sado e vogël e ka efektin e madh tek qytetarët e bizneset.

Kryesuesi filloi të i thërras delegatët përmes telefonit.

Pas kësaj u lajmërua Ivana Svilanovic.

Ivana Svilanovic votoi **PËR**, pikën e parë të rendit të ditës,kurse për pikën të ndryshme nuk tha asgjë.

Velibor Kostic . Pas thirrjes telefokime të kryesuesit u lajmërua dhe po ashtu edhe ai votoi **PËR**,aprovimin e pikës së parë të rendit të ditës,po ashtu edhe ai nuk pati asgjë për pikën të ndryshme.

Igor Petkovic U lajmërua pas thirrjes së kryesuesit,ai votoi **PËR**,aprovimin e pikës së parë të rendit të ditës,dhe për pikën të ndryshme nuk pati asgjë për të thënë.

Nijazi Fejza U lajmërua pas thirrjes së kryesuesit,ai votoi **PËR**,aprovimin e pikës së parë të rendit të ditës,dhe për pikën të ndryshme nuk pati asgjë për të thënë.

Slobodan Stoilkovic U lajmërua pas thirrjes së kryesuesit,ai votoi **PËR**,aprovimin e pikës së parë të rendit të ditës,dhe për pikën të ndryshme nuk pati asgjë për të thënë.

Naser Shabani U lajmërua pas thirrjes së kryesuesit,ai votoi **PËR**,aprovimin e pikës së parë të rendit të ditës,dhe për pikën të ndryshme nuk pati asgjë për të thënë.

Tijana Vujic Pasi u lajmërua në thirrjen e kryesuesit,ajo kërkoi që kryesuesi t'ia lexoj rendin e ditës,kryesuesi e lexoi rendin e ditës dhe tha se bëhet fjalë për pagesën e taksës nga 8 deri në 10 euro për personat juridik,kurse për qytetarët e thejstë 3 euro,ajo më pas pyeti a ndyshohet ndonjë gjë apo mbetet siç ka qenë më parë,kryesuesi e vërtetoi se çdo gjë mbetet ashtu siç ka qenë,dhe më pas ajo votoi **PËR**,kurse për pikën të ndryshme tha që më shumë ti kushtohet vëmendje mbi mbeturinat në fshatrat Vërbovc dhe Grncar,kryesuesi i tha që do ta ket parasysht kërkesën e saj dhe se do të ndërmerren masa lidhje me këtë,e falemderoi dhe e përshëndeti.

Afize Rexepi U lajmërua pas thirrjes së kryesuesit,ai votoi **PËR**,aprovimin e pikës së parë të rendit të ditës,dhe për pikën të ndryshme nuk pati asgjë për të thënë.

Shqepri Rexepi U paraqit në telefon pas thirrjes së kryesuesit,dhe ai votoi **Kundër**,për shkak se nuk e ka marrë matërijalin për 2 seancat e më parshme,tani kam marrë vetëm ftëesën pa procesverbal dhe po ashtu kërkoi sqarim nga kryesuesi përse nuk e ka marrë procesverbalin,kryesuesi theksoi se do ta marrë në seancat e radhës. Shqiprimi theksoi se voton **Kundër** për shkak se kjo shumë është e lartë dhe se kjo duhet të ndryshohet,për pikën të ndryshme ai kërkoi listën e subvencioneve ashtu siç e ka kërkuar në seancën e kaluar,kryesuesi i tha që të vijë në komunë dhe që do ta merr atë që po e kërkon.

Miroslav Mirkovic U lajmërua në thirrjen e kryesuesit,ai **Absteoi** sepse nuk kishte të kjashtë diçka lidhur me këtë pikë,a është kjo pagesë mujore apo vjetore,kryesuesi tha që kjo pagesë është mujore,dhe i dha mundësinë që të jap ndonjë propozim lidhje me këtë si delegat i kuvendit,ai shtori që vetëm **ABSTENON**,dhe për pikën të ndryshme ai deshi vetëm të pyes se a duhet të vij në komunë për të nënshkruar listën e pjesëmarrjes në seancë,kryesuesi i tha se duhet të vijë ,duke i dhënë afat prej 4- 5 ditë që të vijë në zyren e kryesuesit dhe të nënshkruaj.

Vesna Przic U lajmërua në thirrjen e kryesuesit po ashtu edhe ajo **ABSTENOI**,për pikën të ndryshme nuk pati çfarë të shtoj.

Ognjen Krčmarović U lajmërua në thirjen e kryesuesit, nuk e kishte të kjashtë se a po rritetn tarifën,kryesuesi tha se e gjitha kjo mbetet njëjt. Dhe ai **ABSTENOI**,për pikën të ndryshme pyeti vetëm kur duhet të vijë të nënshkruaj listën e pjesëmarrjes,kryesuesi që mund të vij deri në fund të muajit.

Kryesuesi në fund e thirri dekegatin Strahinja Spasic dhe e përshëndeti,e pyeti se a e kishte marrë materijalin e duhur për seancë.

Strahinja Spasic U ljamërua dhe tha se **ABSTENOJ** për ikën e parë,për pikën të ndryshme nuk kam çfarë të them.

Kryesuesi pastaj tha se tani është radha që edhe unë të votoj, unë votoj **PËR** aprovimin e kësaj pike,kurse për pikën të ndryshme nuk kam çfarë të them. E falemderoj Diturien,Dragisën dhe asistentit Vlasta Bogdanovic,po ashtu edhe nënkryetarin e komunës z,Sasa Mirkovic po e mbyll seancën e sotme edhe një herë Ju falemderit shumë.

Procesmbajtësja

kryesuesi i Kuvendit



\Zorica Zdravkovic\



\Zarko Dejanovic\

Datë:25.11.2020